

ÇFARË ËSHTË EKSTREMIZMI I DHUNSHEM

Procesi i adoptimit të pikëpamjeve radikale (politike, ideologjike ose fetare) dhe kthimit të tyre në veprime të dhunshme.

Mund të jetë ekstremizëm i majtë, i djathtë apo/dhe fetar që:

- ✓ Përdor dhunën
- ✓ Promovon uniformitetin kundër diversitetit
- ✓ Vendos objektiva të përbashkëta përkundër lirive individuale
- ✓ Imponim në vend të dialogut.

MOTIVE TE PËRFSHIRJES NE EKSTREMIZEM TE DHUNSHËM

- ✓ **Dhuna ideologjike:** (a) Ideologjitë politike siç janë grupet nacionaliste, neonaziste, etj., që kanë në themel përdorimin e dhunës; (b) interpretime ekstreme të ideologjive fetare dhe besimeve (c) anarkistët e majtë të dhunshëm dhe ideologjitë djathtiste.
- ✓ **Dhuna që bazohet në kauza:** (a) lëvizjet e dhunshme për të drejtat e kafshëve; (b) ekstremizmi mjedisor ose ekologjik (c) lëvizjet antiqeveritare, anti-globaliste ose antikapitaliste që përkrahin përdorimin e dhunës.
- ✓ **Dhuna etno-nacionaliste ose separatist:** betejat e dhunshme politike ose të pavarësisë që kanë në themel racën, kulturën, gjeografinë ose etninë.

TIPARE TË PËRBASHKËTA TË EKSTREMISTËVE TË DHUNSHME

- ✓ Anti-kushtetues
- ✓ Anti-demokratikë
- ✓ Anti-pluralistë
- ✓ Autoritaristë
- ✓ Fanatikë
- ✓ Intolerantë
- ✓ Të pakompromisë
- ✓ Refuzojnë shtetin e së drejtës
- ✓ Përdorin dhunën për arritjen e objektivave politike

ÇFARË ËSHTË RADIKALIZIMI?

- ✓ RADIKALIZMI - Procesi i zhvillimit të ideologjive dhe pikëpamjeve ekstremiste, i cili mund të jetë i dhunshëm ose jo
- ✓ RADIKALIZIMI I DHUNSHËM - Procesi i përqafimit të opinioneve, pikëpamjeve dhe ideve që mund të çojnë në akte terrorizmi
- ✓ Që nga viti 2014, rreth 150 shtetas shqiptar, disa prej tyre së bashku me anëtarët e familjes, janë larguar nga vendi për t'u bashkuar me zonat e luftës në Lindjen e Mesme. Shumë prej tyre janë kthyer në Shqipëri dhe jetojnë në kushte të përjashtimit apo vetë-përjashtimit social, për një pjesë tjetër, gra e fëmijë, po punohet për sjelljen e tyre ne shtëpi.

FAKTORËT E BRENDSHËM QË NDIKOJNË NË RADIKALIZËM DHE EKSTREMIZËM TË DHUNSHËM

- ✓ **Kriza e identitetit** - verehet më shumë gjatë adoleshencës.
Karakteristika dhe tiparet individuale të cilat dallojnë një person të caktuar përbëjnë identitetin
- ✓ **Kriza personale** - problemet që ndeshen në jetën personale e familjare
- ✓ **Rrethanat personale** – psh emigrimi, tensione apo ngjarje të caktuara në vendin ku jeton, përvojat personale të vuajtjes për shkak të diskriminimit, etj
- ✓ **Nevoja/Aspirata të papërbushura** - pamundësia e plotësimit të dëshirave apo qëllimeve, shpesh herë joreale

FAKTORËT E JASHTËM QË NDIKOJNË NË RADIKALIZËM DHE EKSTREMIZËM TË DHUNSHËM

- ✓ **Mediat sociale** – gjejnë kryesisht përdorim në moshat e reja dhe përdoren si një rrugë e lehtë dhe e shpejtë për të shpërndarë ideologji të gabuara
- ✓ **Familja** – në situata normale është faktor stabilizues, por mund të jetë shtytse drejt individëve apo ideologjive jo të duhura kur nuk është e shëndetshme
- ✓ **Bashkëmoshatarët** - janë faktor i rëndësishëm në procesin e formimit të individit dhe mund ndikojnë në përhapjen e paragjytimeve, ideve apo veprimeve radikale
- ✓ **Mjedisi/konteksti social** – shtetet, vendet apo hapësirat ku lindin dhe ushqehen paragjykimet

SHENJA PARALAJMËRUESE TË RADIKALIZIMIT DHE EKSTREMIZMIT

- ✓ Luhatje humori, humbje të papritur të lartë të interesit, si dhe largim nga gjërat me të cilat janë marrë më parë, si familja apo miqtë
- ✓ Krijimi i miqësive/njohjeve të reja, të cilët fshehin identitetin dhe kanë ndikim negativ mbi ta
- ✓ Ndryshime të përgjithshme në gjendjen shpirtërore dhe sjellje të luhatura lidhur me ushqimin ose paratë (kursim apo shpenzim në mënyrë të papritur)
- ✓ Ndryshime të papritura dhe të mëdha në pamje ose në veshje
- ✓ Komentë antisociale, refuzim të autoritetit, refuzim për të bashkëvepruar në mënyrë shoqërore, tërheqje në vete dhe izolim

SHENJA PARALAJMËRUESE TË RADIKALIZIMIT DHE EKSTREMIZMIT

- ✓ Të qenët i fshehtë dhe ngurrues për të diskutuar aktivitetet, vendndodhjen dhe bashkëpunëtorët
- ✓ Kalimi i kohës së tepërt në internet ose në telefon, duke ndryshuar identitetin online, duke patur telefona celularë ose pajisje të ngjashme dhe duke i mbajtur ato private në mënyrë strikte
- ✓ Të folurit në mënyrë të përçarë 'ata dhe ne' apo me fjalë përçmuese ndaj të tjerëve të cilët janë të ndryshëm, duke refuzuar të merren me ta ose duke abuzuar ndaj tyre
- ✓ Përgatitje për të thënë lamtumirë;

SHENJA PARALAJMËRUESE TË RADIKALIZIMIT DHE EKSTREMIZMIT

- ✓ Interesimi i papritur për politikën e brendshme ose të jashtme, duke shfaqur mosbesim dhe irritim ndaj politikëbërësve;
- ✓ Rritja e ndjeshmërisë ndaj teorive apokaliptike e konspirative dhe ndjenjave të persekutimit;
- ✓ Shprehja e pikëpamjeve radikale apo mbështetja e pikëpamjeve të tilla, duke justifikuar e mbështetur veprime, mesazhe, akte apo mjete ekstremiste e të dhunshme;
- ✓ Përdorimi i literaturës dhe imazheve ekstremiste;
- ✓ Vendosja e kontakteve me rekrutuesit ekstremistë, duke u bashkuar ose duke u përpjekur për t'u bashkuar me organizatat ekstremiste dhe përpjekje për të rekrutuar të tjerë në ideologji ekstremiste;

ETAPAT E PROCESIT TË RADIKALIZIMIT

Etapa 1	Etapa 2	Etapa 3	Etapa 4
<ul style="list-style-type: none">• Vendosja e kontaktit midis “radikalizuesit” dhe një personi të hapur ndaj ideve radikale.	<ul style="list-style-type: none">• Ndryshim gradual i sjelljes – ndryshim në sjellje.• Zakone/forma të reja komunikimi (kryesisht nëpërmjet internetit).	<ul style="list-style-type: none">• Ndryshim i jetës sociale, duke u shoqëruar gjithnjë e më shumë me individë me mentalitet të ngjashëm. (Socializim)• Ndërprerje ose kufizim i lidhjeve shoqërore me familjen dhe miqtë e mëparshëm.	<ul style="list-style-type: none">• Procesi i “kalitjes” morale, kryesisht duke parë video shumë të dhunshme dhe skena luftimi.• Largimi drejt zonave të luftimit, ose përfshirje në akte terroriste në vend

ROLI I GRAVE NE PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

1. Gratë si parandaluese të ekstremizmit të dhunshëm
2. Barazia gjinore si objektiv dhe strategji për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm
3. Praktikuese të vijës së parë
4. Njohëse të realitetit në komunitet
5. Nyje hyrëse në komunitete të mbyllura

DHUNA DHE LLOJET E SAJ

FIZIKE

thikë/me armë,

shtyrje, goditje, gërvishtje, mbyllje në shtëpi, kërcënim me tentativë për vrasje, vrasje

PSIKOLOGJIKE

vazhdueshme,
kontrolli ndaj

kërcënimet, ndjekja nga pas, ndalimi për të dale, kritika e sharjet, talljet/vëniet në lojë, ngarkimi me faj për çdo gjë, veshjes, të folurit, etj

EKONOMIKE

vlefshme,

kontrolli i parave, shtyrja/nxitja për të vjedhur ose shitur gjëra të mohimi i mundësisë që pasuria të jetë edhe në emër të partneres/bashkëshortes

DHUNA SEKSUALE

detyrimi
seks me një

marrëdhënie seksuale me force, trajtimi i partneres si objekt seksual, për të kryer seks në forma të padëshiruara, detyrimi për të kryer partner tjetër, detyrimi për të ushtruar prostitucion

DHUNA ME BAZË GJINORE

Ndodh për shkak të gjinisë, e cila i ka rrënjët në mënyra të caktuara të menduarit apo forma ose norma të ndryshme shoqërore

ARSYET E DHUNËS NË FAMILJE

- ✓ Gjendja e vështirë ekonomike/papunësia
- ✓ Mentaliteti patriarkal i shoqërisë
- ✓ Mungesa e respektit ndaj gruas (konsiderimi i tyre inferiore ndaj meshkujve)
- ✓ Përdorimi i alkoolit/lëndëve narkotike
- ✓ Humbja e vetëkontrollit
- ✓ Mungesa e komunikimit
- ✓ Probleme në mardhëniet në çift

PSE TOLEROHET DHUNA NË FAMILJE

- ✓ Konsiderohet si çështje turpi
- ✓ Konsiderohet si pjesë e jetës martesore
- ✓ Sakrifikimi për fëmijët
- ✓ Mungesa e mbështetjes ekonomike
- ✓ Opinioni i të tjerëve

KU DUHET DREJTUAR DHE MEKANIZMAT MBROJTËS

- ✓ Posta e policisë më të afërt
- ✓ Njësia përkatëse vendore
- ✓ Qendra shëndetësore
- ✓ Kërkesë padi gjykatës

- ✓ Çfarë është një urdhër mbrojtje?
- ✓ Çfarë lloj mbrojtje mund të gjeni?



BARAZIA GJINORE OSE BARAZIA MIDIS BURRAVE DHE GRAVE

- ✓ Të drejtat, përgjegjësite dhe shanset e barabarta të grave dhe burrave, për të njëjtat mundësi dhe burime
- ✓ Interesat, nevojat dhe prioritetet e grave dhe burrave merren parasysh njësoj
- ✓ Nuk ka të bëjë vetëm me gratë, por duhet të përfshijë dhe angazhojë plotësisht burrat dhe gratë
- ✓ Është çështje e të drejtave të njeriut dhe një parakusht i domosdoshëm për zhvillim të qëndrueshëm



FORMA TË PABARAZIVE GJINORE

Pabarazitë në ndarjen e punëve, mundësitë për shkollim, punësim dhe aspektet ekonomike:

- ✓ Gratë/vajzat dhe burrat/djemtë mbajnë ngarkesa të ndryshme të punëve në familje
- ✓ Gratë dhe vajzat (sidomos në zonat rurale) kanë mundësi të ndryshme për shkollim
- ✓ Gratë dhe vajzat (sidomos në zonat rurale) kanë mundësi të ndryshme për punësim
- ✓ Gratë/vajzat marrin paga më të ulëta për punë të ngjashme/të njëjtë me burra
- ✓ Gratë/vajzave shpesh u mohohen të drejtat e barabarta që lidhen me statusin personal, sigurinë, pronën, tokën, trashëgiminë siç edhe parashikohet në ligj.

STERIOTIPET GJINORE

Gjinia e kundërt konsiderohet me disa cilësi, aftësi, sjellje inferiore apo sipas mënyrës, perceptimit dhe dëshirës tone

- ✓ Kryetari i familjes dhe vendimmarrësi është burri
- ✓ Fjala e fundit i takon burrit në familje
- ✓ Gratë dhe vajzat nuk duhet të marrin pjesë në vendimet e familjes
- ✓ Gratë duhet t'u binden burrave
- ✓ Gratë dhe vajzat duhet të merren me punët e shtëpisë dhe rritjen e fëmijëve
- ✓ Burrat sjellin pjesën më të madhe të të ardhurave
- ✓ Burrat mund/duhet të merren me politikë